

“ReMusica” - promotori i muzikës së re



- [Të dielën në mbrëmje Finalja e “Top Fest 8”](#)
- [Koncert i instrumentistëve zviceranë dhe gjakovarë](#)
- [Mbyllet konkursi i GAK „Artistët e së Nesërme 2011“](#)
- [“ReMusica” - promotori i muzikës së re](#)
- [Sot panairi i 13-të i librit, “Koha” me 16 tituj të rinj](#)
- [Qeveria deklaron përkushtimin ndaj komunitetit artistik](#)
- [Teatri Profesionist i Gjakovës shfaq premierën e tretë](#)
- [Në Ferizaj sonte nis “Ditët e kulturës 2011”](#)
- [Ulqini, nikoqir i piktorëve nga trojet shqiptare](#)
- [Ali Podrimja fitues i “Muzës së Agimit”](#)

Publikuar: 03.06.2011 - 11:17

Prishtinë, 3 qershor - Festivali i muzikës së re u mbyll me instrumentistë të rinj. Afër pesëdhjetë instrumentistë, kompozitorë e këngëtarë të rinj kanë parakaluar të enjten mbrëma në një koncert maratonik që ka zgjatur për më shumë se tri orë. Kësisoj është mbyllur edicioni i dhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Prishtinës për Muzikën e Re - “ReMusica”. Veprat e kompozitorëve vendës, si Rauf Dhomi, Arbenita Lubishtani, Fatos Lumani, Aleksadër Peci e Feim Ibrahimimi kanë qenë në repertorin e koncertit të së enjtes.

Kompozitori Kushtrim Gashi, koordinator i programit në “ReMusica”, të cilit i është ekzekutuar një vepër në natën e fundit, ka thënë se ky ka qenë njëri ndër edicionet më të veçanta.

“Nuk mendoj se do të ketë program më të mirë sesa këtë vit. Kemi pasur interesim të madh nga artistë dhe kësisoj ne kemi ofruar cilësi të lartë artistike. Artistët të cilët ishin në këtë edicion tashmë janë pjesë e ‘ReMusicas’ dhe ata do ta pasurojnë këtë festival”, ka thënë Gashi. Sipas tij “ReMusica” do të sjellë gjithmonë emra të njohur që të do të bëjnë performanca interesante dhe cilësore.

E njëra nga performancat e këtij lloji ka qenë ajo e klarinetistes amerikane Krista Martynes. E njohur si artiste multimediale e cila sjell një jetë të re në standard dhe në repertor, në performancën e saj që është reprizuar edhe të enjten mbrëma pas shfaqjes së parë të hënën që shkoi, ajo ka treguar se si zgjeron performancën e saj me improvizime inventive që përthekojnë audio dhe video.

Për vetë klarinetistin Martynes, pritja e mirë e publikut kosovar e ka bërë të ndjehet shumë mirë.

Ajo vetë pranon se nuk bën këtë lloj performance për të ndryshuar muzikën klasike, por për t'i dhënë asaj frymë të re.

“Mirëpo unë dua që muzika klasike të mos mbetet vetëm me instrumente. Bota po ndryshon, teknologjia gjithashtu, pse të mos i involvojmë këto”, ka thënë ajo.

Martynes ka thënë se ajo çfarë dëshiron ajo të arrijë përmes kësaj muzike është që klasikja të jetë diçka avangarde. Sipas saj “ReMusica” ka qenë festivali perfekt për performancën e saj.

Edhe për kompozitorin Julien-Robert Legault Salvail, që kompozon vepra për amerikanen, ka thënë se muzika e re është duke u bërë më e famshme për çdo ditë.

Për kompozitoren e cila ka përfunduar kompozimin në muzikë elektroakustike, Donika Rudi, e cila është edhe drejtoreshë artistike e “ReMusica”, performimet e muzikës së re e kompletojnë festivalin.

Rudi ka thënë se në çdo edicion ajo sjell një vepër të kompozuar në këtë formë.

“Do ta bëj edhe viteve të tjera”, ka shtuar ajo.

Pjesë e veprës së Rudit të ekzekutuar nga klarinetisja amerikane ka qenë edhe këngëtarja Rona Nishliu. Ajo ka thënë se kur e ka dëgjuar veprën ka qenë e bindur se do të jetë e suksesshme.

“Jam shumë e hapur nga ideve të reja dhe ReMusica po e bën këtë”, ka thënë Nishliu. Gjatë nëntë ditëve të “ReMusica 2011” kanë performuar instrumentistë të njohur botërorë. Kiaristi Petrit Çeku, trompetisti Roman Leleu, pianistja Aki Takahashi e klarinetistja Krista Martynes kanë qenë vetëm disa prej tyre.